



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT
AGJENCIA KOMBETARE E MJEDISIT

Drejtoria e Vlersimit të Mjedisit.

Spektori I Përgjegjësisë Mjedisore ka si objektiv parandalimin dhe rekuperimin e dëmeve që i shkaktohen mjedisit. Nëpërmjet organizimit të punës së sektorit tentohet rehabilitimin i mjedisit, të bazuar në nenin 12 parimin “Ndotësi Pagan” të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, ku parashikohet se:

“Personi fizik apo juridik, veprimet ose mosveprimet e të cilit ndikojnë në ndotjen e mjedisit, mban përgjegjësi financiare, duke përballuar kostot e shkaktuara nga ky dëmtim apo rrezik për dëmtimet e mjedisit”.

Spektori i Përgjegjësisë Mjedisore harton dhe prezanton masat dhe praktikave që synojnë minimizimin e rrezikut të dëmtimit në mjedis, bazuar në nenin 50 “Përgjegjësia për dëmin në mjedis” të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, e cila parashikon se:

1. Qëllimi i përgjegjësisë për dëmin në mjedis, mbështetur në parimin “Ndotësi pagan”, është:

- a) parandalimi dhe zhvendëtimi i të gjithë dëmit që i shkaktohet mjedisit;
- b) rehabilitimi i mjedisit;
- c) prezantimi i masave dhe i praktikave për minimizimin e rrezikut të dëmtimit të mjedisit.

Eprori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit ka ngarkuar edhe Sektorin i Përgjegjësive Mjedisore të jete përfaqesues në procesin e Konsultimit me Publikun sipas VKM dt. 30.04.2014 për “Përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore

Drejtoria e Vlersimit të Mjedisit, urdhëron Sektorin i Përgjegjësive Mjedisore të mbajë protokollin dhe të përditesojë regjistrin për raportet e vetmonitorimit që dorëzohen pran AKM për lejet e tipit A, B dhe C.

Spektori i Përgjegjësisë Mjedisore ka si objektiv të analizoj cdo Raport Monitorim që dorëzohet nga Shoqërit pranë kësaj zyre duke bazuar nga aktet nënligjore dhe vlen të përmendim, Ligjit nr. 9024, datë 6.3.2003 “Për akreditimin e laboratorëve testues kalibrues, organizmave certifikues dhe inspektues në Republikën e Shqipërisë”, të VKM nr. 435, datë 12.9.2002 “Për normat e shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”, të VKM nr. 1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”, të VKM nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjedisëve ujore pritëse”, Udhëzimit nr.

8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedisë të caktuara”, ju vëmë në dijeni për sa më poshtë vijon:

Sektori i Përgjegjësive Mjesiore i dorëzon subjekteve vërtetim “Për dorëzimin e raportit të vetmonitorimit” pasi të ketë protokolluar në regjister raportet e vetmonitorimit. Raportet e vetmonitorimit pasi protokollohen, një kopje i dorëzohet në Drejtorinë e Informacionit dhe Statistikave , Sektor i Regjistrimit të Shkarkimeve dhe Transferimit të Ndotjes. Të dhënat e vetmonitorimit hidhen në databazen e Regjistrimit të Shkarkimit dhe Transferimit dhe Statistikave dhe kjo e fundit administratohet nga Drejtoria e Informacionit dhe Statistikave.

Mbajta e regjistrimit ka si objektiv logaritjen, mbajtjen në kontroll si në kohë dhe në monitorim të subjekteve sipas lejes përkatëse me nënkushtin e saj që subjekt duhet të dorëzojë raportin e vetmonitorimit cdo 3-6 muaj pran AKM.

Detyrat Kryesore:

1. Organizon punën me specialistët e sektorit me qëllim përmbushjen e detyrave të sektorit.
2. Organizon punën për marrjen e masave të nevojshme parandaluese.
3. Vlerëson natyrën, shkallën dhe rëndësinë e secilit prej dëmeve të shkaktuara në mjedis, rrezikun ndaj shëndetit të njeriut si dhe aftësinë e rehabilitimit natyror.
4. Punon së bashku ISHMPU dhe ekipin e sektorit për identifikimin e operatorëve që janë kërcënim i drejtpërdrejt për një dëm të mundshëm, apo atyre që kanë shkaktuar dëm, në bashkëpunim me strukturat lokale (DRM-të).
5. Ndërmer masat e nevojshme ligjore për detyrimin e operatorëve që kanë dëmtuar mjedisin në mënyrë të parikuperueshme të paguajnë kompensim për dëmin e shkaktuar. Propozon dhe kërkon sigurimin e fondeve shtesë nga Buxheti i Shtetit për rehabilitimin e dëmeve mjedisore në raste të veçanta.
6. Menaxhimi i dosjes së subjekteve që kanë dërguar të dhëna për vetmonitorimin.
7. Menaxhimi i dosjeve të sektorit.
8. Menaxhimi i dosjes së aktiviteteve me ndikim të lartë në ndotjen e mjedisit dhe në shëndetin e njerëzve.